



A2023053120179461724

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“LOBI TECHNOLOGY SH.P.K”**

Sot, para meje Noter MARGENA U. ÇELA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Astrit BALLUKU, u paraqiten personalisht:

**NE THEMELUESIT:** **Abdulrahim Alsamman**, shtetas Argjentinas, lindur në Syr dhe banues në Argjentine, lindur më 20/02/1974, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. AAE266136 dhe nr. personal 19048517.

**Aghead Alkoko**, shtetas Austriak, lindur në Hama dhe banues në Austri, lindur më 01/01/1985, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. K1456240.

**Enver Zekaj**, shtetas Kosovar, lindur në Novoselle dhe banues në KOSOVE, lindur më 25/11/1969, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. P01559562dhe nr. personal 1170566099 .

**Kristian Dimo**, atësia Artan, amësia Nertila, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Bajram Curri; Nd. 134; H. 13; Ap. 11; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 26/12/1994, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038720622 dhe nr. personal J41226044E ,

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 28.10.2020, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**LOBI TECHNOLOGY SH.P.K**”, me aktin themelues të saj si vijon :

**FORMIMI  
NENI 1**

Formohet shoqëria private e quajtur “**LOBI TECHNOLOGY SH.P.K**”.

Shoqëria do ti nënshtrohet legjisacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjisacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

**SELIA E SHOQERISE  
NENI 2**

Selia e shoqërise tregtare private “**LOBI TECHNOLOGY SH.P.K**” do të jetë :

Rruja: "Ismail Qemali" Pallati Fratari Nr. 27, Tirane.

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci oprative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakeve themelues të saj.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE  
NENI 3**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

*Jaghed Alkoko*

*W. [Signature]*



A2023053120179461724

- Përpunimit i të dhënave, vendosja dhe kryerja e aplikacioneve ne fusha te ndryshme nepermjet sistemit online dhe ofrimi i shërbimeve nepermjet perdorimit te ketyre aplikacioneve online, Disenjim software-i, ku përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software; Zhvillim sistemesh migrimi, ku përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re; Përmirësim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, ku përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike; Testim software, ku përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, ku përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN); Siguria kibernetike (cyber security ) Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, ku përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, 2 projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse, organizues eventesh dhe konferencash. Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj; Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

#### NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 5


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

#### KAPITALI I SHOQERISE

#### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “LOBI TECHNOLOGY SH.P.K” do të jetë 100.000 (njeqind mijë) lekë. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar ), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga 4 kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me 25 000 lekë, perkatesisht:

- Z. Abdulrahim Alsamman zotron 1 kuote me vlerë 25 000 leke që perben 25 % te kapitalit themeltar;
- Z. Aghead Alkoko zotron 1 kuote me vlerë 25 000 leke që perben 25 % te kapitalit themeltar;
- Z. Enver Zekaj zotron 1 kuote me vlerë 25 000 leke që perben 25 % te kapitalit themeltar;
- Z. Kristian Dimo zotron 1 kuote me vlerë 25 000 leke që perben 25 % te kapitalit themeltar;



A2023053120179461724

Kapitali themeltar fillesttar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### NENI 7

Ortaket e Shoqerise duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

### DREJTIMI I SHOQERISE NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, **Z. Kristian Dimo** i cili është edhe përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhe kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë.

#### NENI 10

Ortaket themelues kane të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjera të shoqërisë ne cdo kohe qe ata e vleresojne te arsyeshem. Ata ka të drejtë të caktoje financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjera si ekspert nese do te jete e nevojshme. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

#### NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykojen dhe zgjidhen në zbatim të legjisacionit shqiptar në Gjykatën E Shkalles Se Pare Juridiksioni i Pergjithshem Tiranë.

#### NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme.

#### NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në kater kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra mbahet ne zyrenotariale, njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "**LOBI TECHNOLOGY SH.P.K.**".

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Bashkelidhur ketij akti: akt themelimi ne gjuhen Angleze.

### THEMELUESIT

Abdulrahim Alsamman *Abdulrahim*

Aghead Alkoko *Aghead ALKOKO*

Enver Zekaj *ENVER ZEKAJ*

Kristian Dimo *Kristian Dimo*

### NOTER

MARGENA U. ÇELA